



*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik,

**Vëren:**

**I**

Në datën 22.11.2023, Komisioni i Prokurimit Publik ka marrë vendimin Nr. 1206/2023.

**Vendos**

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. LOT 2 REF-78046-08-22-2023, me objekt: “Loti 2 Makineri kompjuterike dhe zyrash, pajisje dhe furnizime përjashtuar mobiljet dhe paketat softëare” me fond limit 2.571.250 (dymilion e pesëqindë shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Për Persona me Aftësi të Kufizuara.*
  2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “RO-AL” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*
  3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
  4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.*
  5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
  6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**Komisioni i Prokurimit Publik**

**Arsyeton:**

I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon që, në Vendimin Nr. 1206/2023 të datës 22.11.2023, të korrigjojë përbërjen e Komisionit të Prokurimit Publik,

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 112 e 129 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe

*funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

### **Vendos**

Të korrigjojë vendimin Nr. 1206/2023 datë 22.11.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë:

**Ishte:** Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

**Bëhet:** Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

